

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                   |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Aktivitetet kulturore/ Nga koncerti 'Dritat e Spanjës' te Java Kulturore Kroate dhe 'Tirana Photo Festival' - Informohu siç duhet |
| ADRESA  | https://radar.al/aktivitetet-kulturore-nga-koncerti-dritat-e-spanjes-te-java-kulturore-kroate-dhe-tirana-photo-festival/          |
| BURIMI  | radar.al                                                                                                                          |
| GJENDJA | online                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 26 shtator 2026, 14:46:49 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 14:45:34 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 7a0837643e38651e560d34dd3fe1c70918991dfcdc7e864a99c364f255924650 |
| TEKSTI     | 6fc6cb7884e157fba29f0daff1e61b7e223afd9159d65f9eebef4f37b5782d86 |
| PAMJA      | 2cb1f79c16b7a6af038b16fa09eb0a778545f72ef5f59363594dee99bbd01fe5 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 94b40e66d5eee5b039787cd57fb579ecf0af60ca6788eafb6c0b5f1848ea090a                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/94b40e66d5eee5b039787cd57fb579ecf0af60ca6788eafb6c0b5f1848ea090a

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




YOU ARE AT: Home » Aktivitetet kulturore/ Nga koncerti 'Dritat e Spanjës' te Java Kulturore Kroate dhe 'Tirana Photo Festival'

KULTURË

Demo

## Aktivitetet kulturore/ Nga koncerti 'Dritat e Spanjës' te Java Kulturore Kroate dhe 'Tirana Photo Festival'

SEPTEMBER 26, 2026



### 1. "QUEER FILM MARATHON TIRANA", HAPJA E EDICIONIT TË 7-TË

Edicioni i 7-të i "Queer Film Marathon Tírana" do të hapet të dielën, më 27 shtator, me një mbrëmje speciale në Universitetin e Arteve në Tiranë. Në ceremoninë e hapjes, që nis në orën 19:00, do të mbahet një koncert privat nga artistja shqiptare Mira Konçi, kumbara e festivalit për këtë vit, e shoqëruar nga maestro Ekland Hasa. Nga 27 shtatori deri më 25 tetor, festivali do të sjellë në Tiranë filma, të ftuar ndërkombëtarë, biseda, ekspozita dhe evente speciale kushtuar historive, identiteteve dhe zërave queer.

### 2. "TRASHËGIMIA E ZEJTARISË SHQIPTARE", DITË KUSHTUAR TRADITËS

"Trashëgimia e Zejtarisë Shqiptare" do të zhvillohet më 27 shtator në Pazarin e Ri në Tiranë nga ora 11:00 deri në 14:00. Aktiviteti do të sjellë së bashku artizanë, traditë, këngë, valle dhe art, duke krijuar një mundësi për publikun për të njohur nga afër mjeshtërinë e zejeve tradicionale dhe për të vlerësuar trashëgiminë kulturore shqiptare.

### 3. "DUKE KUNDRUAR BIZANTIN NGA SHQIPËRIA", SHFAQJE NË TIRANË

Dokumentari "Duke kundruar Bizantin nga Shqipëria" do të shfaqet të dielën, më 27 shtator në orën 19:00 në hapësirën e BERK në Tiranë. Aktiviteti zhvillohet me rastin e BRIA FEST 2026 dhe në kuadër të Ditëve Europiane të Trashëgimisë. Pas dokumentarit do të zhvillohet një bashkëbisedim mbi trashëgiminë bizantine në Shqipëri, me pjesëmarrjen e Andi Rembecit dhe Sokol Çungës.

### 4. "SHQIPËRIA ËSHTË BIODIVERSITET", MOZAIKU I KLEIDI ESKIT

Mozaiku "Shqipëria është Biodiversitet", i realizuar nga artisti Kleidi Eski, do të përurohet më 26 shtator në orën 17:30 në hapësirën/galerinë hbs, në Sheshin Skënderbej pranë Muzeut Historik Kombëtar. Mozaiku është pjesë e një fushate të PPNEA dhe Fondacionit Heinrich Böll, që synon të sjellë biodiversitetin shqiptar më pranë publikut dhe të rrisë ndërgjegjësimin për pasurinë natyrore të vendit. Vepra bashkon 38 lloje të veçanta dhe të kërcënuara që gjenden në Shqipëri, në një riinterpretim bashkëkohor të mozaikut "Shqiptarët" në fasadën e Muzeut Historik Kombëtar. Krahas mozaikut do të prezantohet edhe një ekspozitë edukative dhe një program publik me bashkëbisedime, punëtori, shfaqje filmash dhe aktivitete kulturore.

### 5. ÇELET JAVA KULTURORE KROATE, KONCERT I "AD GLORIAM BRASS"

Java Kulturore Kroate do të zhvillohet më 26-29 shtator, me një program të pasur kulturor që sjell muzikë, teatër, trashëgimi dhe bashkëpunim shqiptaro-kroat. Programi do të çelot sot në orën 18:00 në hollin koncertor të TKOB me koncertin e "Ad Gloriam Brass", një nga ansamblet më të njohura të

### Postimet e reja

Aktivitetet kulturore/ Nga koncerti 'Dritat e Spanjës'...

SEPTEMBER 26, 2026

Eric Wendt nis misionin në Tiranë, Ambasada e SHB...

SEPTEMBER 26, 2026

Profili i Indrit Dokles/ Nga dënimi i përgjeshëm te...

SEPTEMBER 26, 2026

Aksident në aksin Gjirokasër-Kakavijë,...

SEPTEMBER 26, 2026

### Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

**Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive**

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

**ALERT në Sloveni për VIPA**  
Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

**Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits"**  
të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

**Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare**

### Na ndiq

tunxhit në Kroaci. Koncerti me muzikë klasike, kolona zanore filmash dhe muzikë të njohur në aranzhime për instrumente tunxhi do të mbahet edhe nesër në orën 19:00 në katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër.

6. “NE JEMI NDARYSHE”, SHFAQJA E CIRKUT KOMBËTAR TE KUKULLAT

“Ne jemi ndaryshe” është shfaqja nga artistët e Cirkut Kombëtar, që do të vijë sot në orën 17:00 në Teatrin e Kukullave.

7. “DRITAT E SPANJËS”, KONCERT NGA ORKESTRA SIMFONIKE E RTSH-SË

“Dritat e Spanjës” është mbrëmja muzikore që do të mbahet nga Orkestra Simfonike e RTSH-së në sallën e koncerteve të Universitetit të Arteve, sot në orën 20:00 nën dirigjimin e maestro Facundo Agudin. Ky aktivitet shënon 40-vjetorin e miqësisë mes Spanjës dhe Shqipërisë.

8. “PETER PAN QUARTET” E “PASTA NIGHT” TE PARKU HELEN NË FARKË

“Pasta night” dhe një natë muzikore me “Peter Pan Quartet” do të vijë te Parku Helen në Farkë sot në orën 18:00.

9. FOTOGRAFIA/“TIRANA PHOTO FESTIVAL” VJEN NË EDICIONIN E NËNTË

Edicioni i 9-të i “Tirana Photo Festival” po vijon të mbahet deri më 30 shtator te Instalacioni “Reja” në Tiranë. Këto do të jenë ditë kushtuar fotografisë, artit dhe rrëfimit përmes imazhit, me ekspozitën me 100 fotografi single, ekspozita të përzgjedhura me seri fotografike, uorkshope dhe foto-ture.

10. KOMEDIA “E ZONJA E BUJTINËS”, PREMIERË NË TEATRIN “BYLIS”

“E zonja e bujtinës”, komedia e Carlo Goldonit, një nga veprat e tij më të njohura, do të vijojë të shfaqet edhe sonte në orën 19:00 në skenën e teatrit “Bylis”, nën regjinë e Kiço Londres.

11. “BIG BABY” VIJON SHFAQJET NË TEATRIN KOMBËTAR EKSPERIMENTAL

“Big Baby” do të vijojë të shfaqet në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” në Tiranë edhe sonte dhe nesër në orën 20:00. Me autor Frank Moher, shfaqja vjen nën regjinë e Endri Çelës.

|                   |                      |                      |           |                       |                  |           |
|-------------------|----------------------|----------------------|-----------|-----------------------|------------------|-----------|
| agjenda kulturore | aktivitete artistike | aktivitete kulturore | art       | art dhe kulturë       | Dritat e Spanjës | ekspozitë |
| evente kulturore  | evente në Tiranë     | festival             | fotografi | Java Kulturore Kroate | koncert          | kroaci    |
| kulturë shqiptare | Muzikë               | shqipëri             | spanjë    | Tirana Photo Festival | Tiranë           |           |

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A  
Email: radarlajme@gmail.com  
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu